

Domstoladministrasjonen (Administrata e gjykatave)  
Politiet (Policia)

[www.domstol.no](http://www.domstol.no)  
[www.politi.no](http://www.politi.no)

## PËR JU QË DO TË DËSHMONI NË GJYKATË NË ÇËSHTJEN PENALE

### PARA SE TË VINI NË GJYKATË

- Dëshmitarët janë mjaft të rëndësishëm për sigurinë juridike në shoqëri.
- Nëse polici ose mbrojtësi thonë se duhet të vini në gjykatë dhe të jepni deklaratë, do të thirrreni me shkrim si dëshmitar. Kjo thirrje quhet thirrje gjyqësore /stevning/.
- Nëse doni, mund të lidhni kontakt me gjykatën disa ditë më parë dhe të luteni që të shihni sallën gjyqësore në të cilën do të dëshmoni me qëllim që të njiheni më mirë.
- Jeni të detyruar që të paraqiteni nëse jeni thirrur si dëshmitar. Nëse nuk do të vini me dëshirë, mund të rrezikoni që policia t'ju marrë dhe sjellë në gjykatë me dhunë. Gjithashtu, gjykata mund të caktojë gjobën me të holla për dëshmitarët që nuk paraqiten.
- Nëse jeni të sëmurë ose mendoni se nuk do të mund të paraqiteni para gjykatës, gjykata mund t'ju lirojë nga detyrimi i paraqitjes, por sëmundjen duhet ta dokumentoni me justifikim mjekësor. /legeerklæring/. Gjykata, dhe jo mjeku, vendos a do të paraqiteni.
- Do të jetë mirë, që para se të paraqiteni në gjykatë, të mendoni se çfarë ka ndodhur në lidhje me atë që duhet të jepni deklaratën. Ndoshta mund të freskoni kujtesën tuaj duke parë shënimet, fotografitë etj. që keni në lidhje me atë ngjarje.
- Gjykatat kanë vendosur sistemin në të cilin personat që u japin përkrahje dëshmitarëve /vitnestøtte/ u jep përkrahje humane dhe drejtime praktike dëshmitarëve. Personi për përkrahjen dëshmitarëve është i pranishëm në gjykatë.

### KËSHTU ËSHTË ORGANIZUAR MBLEDHJA E GJYKATËS

- Në gjykatën komunale egzistojnë tre gjykatës në çdo çështje penale. Personi që drejton mbledhjen e gjykatës është drejtues i gjykatës, dhe shpesh quhet administrator /administrator/ dhe rri në mes të tavolinës së gjykatësve. Ai person është jurist. Dy gjykatësit e tjerë janë gjykatës porotë. Personat që paraqiten në gjykatë si gjykatës porotë gjykata i zgjedh nga radha e anëtarëve të regullt të komisionit që e ka emëruar administrata lokale

për këtë shërbim.

- Majtas nga vendi për dëshmitarin rri prokurori. Prokurori përfaqëson shtetin dhe punon në prokurori si prokuror policor /politijurist/ ose prokuror shtetëror /statsadvokat/. I akuzuari vjen bashkë me mbrojtësin e vetë dhe rri në anën e djathtë të vendit për dëshmitarë.
- Duhet të vini në kohën e caktuar dhe të lajmëroheni në recepcion kur të vini.
- Gjyqi sipas regullit është në vazhdim kur hyni të dëshmoni. Në thirrjen gjyqësore është shënuar se në cilën sallë gjyqësore duhet të paraqiteni. Duhet të jeni në korridor para sallës gjyqësore derisa të vijë dikush për Ju.

### OBLIGIMI I DËSHMITIT

Personi që është thirrur si dëshmitar është i detyruar që të vijë dhe të japë deklaratën para gjykatës. Në raste të caktuara dëshmitari mund të lirohet nga detyrimi i dhënies së deklaratës. Bëhet fjalë për dëshmitarët që janë të afërt familjar me të akuzuarit ose dëshmitarë që janë lutur që të mos t'u përgjigjen pyetjeve të cilat do të mund të shkaktojnë dënimin e dëshmitarit. Gjykatësi duhet të kujdeset që të respektohen regullat për lirin nga detyrimi i dëshmitit. Prokurori mund të përgjigjet për pyetjet e obligimit të dëshmitit. Kontaktoni më parë policinë, përkatësisht prokurorin.

### KËSHTU ZHVILLOHET MBLEDHJA E GJYKATËS

- Prokurori e jep fjalën e tij hyrëse para se të dëshmoni, në të cilën shkurtimisht prezenton çështjen. Sipas regullit i pandehuri e ka dhënë deklaratën e vetë, dhe i është përgjigjur pyetjeve të gjykatësit, prokurorit dhe mbrojtësit.
- Pra, Ju nuk do të dëgjoni deklaratën e prokurorit. Kjo bëhet kështu për shkak se Ju duhet të jepni deklaratën Tuaj që nuk është ndikimin e asaj që ka dalë gjatë mbledhjes së gjykatës.
- Nuk është e sigurtë se do të hyni në kohën e caktuar. Kjo varet nga shpejtësia e dhënies së deklaratës të të akuzuarit dhe eventualisht të dëshmitarëve të tjerë. Bëhuni gati të prisni.

- Kur t'Ju vijë radha Juve, do t'Ju thërras prokurori.
- Kur të hyni, gjykatësi do t'Ju tregojë se duhet të zëni vend në vendin për dëshmitarët në mes të sallës gjyqësore. Në fillim gjykatësi do t'Ju pyes se si quheni, ku banoni etj. Më tej do të luteni që të bëni betimin solemn se do të thoni të vërtetën. Pyetjes së gjykatës për këtë Ju do t'i përgjigjeni: "Jap betimin për këtë" / "Det forsikrer jeg på ære og samvittighet."/.
- I akuzuari ka të drejtë që të dëgjojë të gjitha provat, dhe është i pranishëm në sallën gjyqësore derisa jepni deklaratën. Nëse mendoni se kjo është jo e këndshme, mund të kontaktoni disa ditë para gjyqit prokurorin dhe t'i thoni këtë gjë. Në raste të veçanta, gjykata mund të vendos që i akuzuari të ulet në ndonjë vend tjetër ose të largohet nga salla gjyqësore kur jepni deklaratën Tuaj. Kur të kthehet i akuzuari në sallën gjyqësore do t'i thonë se çfarë keni deklaruar.
- Do t'Ju bëhen pyetje në fillim nga prokurori, dhe pastaj nga mbrojtësi. Duhet t'i drejtoheni gjykatësit pa marrë parasysh se kush bënë pyetje.
- Do të jetë mirë që të flisni me zë dhe qartë dhe të jepni shpjegime sa më të tërësishme. Përpiquni të nxirrni të gjitha detajet për të cilat mund të mendohet se janë të rëndësishme për çështjen.
- Duhet të jepni deklaratën me gojë, dhe nuk mund të lexoni deklaratën që e keni marrë me vete. Megjithatë, mund t'i thoni gjykatësit se keni shkruajtur disa fjalë kyçe dhe ta lutni që t'i përdorni si përkrahje të kujtesës Tuaj.
- Të keni parasysh se i akuzuari, prokurori dhe mbrojtësi i kanë lexuar të gjitha dokumentat e policisë. Prandaj, sipas rregullit i akuzuari e di se çfarë keni deklaruar në polici. Përmbajtjen e dokumentave të policisë nuk e dinë tre gjykatësit, dhe prandaj nuk e dinë se çfarë i keni thënë më parë policisë.
- Gjatë procesit mund të jenë të pranishëm vëzhguesit, përveçse në rastet kur gjykatësi ka vendosur që vëzhguesve u ndalohej qasja.
- Në raste të jashtëzakonshme, gjykata mund të vendosë që ta japë deklaratën pa prani personale, pra nëpërmjet telefonit ose video linkut.

### **NË VEÇANTI PËR DËSHMITARËT QË JANË TË DËMTUAR NË ÇËSHTJE**

Personi ndaj të cilit është kryer vepër penale, quhet i dëmtuar në procesin penal. I dëmtuari dhe mbijetuari kanë të drejtë që të jenë të pranishëm gjatë seancës së gjykatës.

I dëmtuari, të cilit gjykata i caktoi përfaqësuesin, sipas rregullit jep deklaratën para të akuzuarit, dhe prandaj duhet të njihet me gjithçka para se të nis çështja. Policia ka hartuar broshurën "Të drejtat e të dëmtuarit dhe person të të vdekurit" / "Fornærmedes og etterlattes rettigheter"/. Atë

mund ta gjeni në polici.

### **PASI KENI DËSHMUAR**

Pas përfundimit të dëshmimit mund të jeni të pranishëm dhe të dëgjoni vazhdimin e procesit nëse dëshironi. Atëherë duhet të zëni vendin e vëzhguesit në fund të sallës gjyqësore. Atëherë mbeten edhe deklaratat eventuale të dëshmitarëve të tjerë, nxjerrja e provave me shkrim dhe fjalët përfundimtare të prokurorit dhe mbrojtësit.

### **MBULIMI I SHPENZIMEVE**

Sipas rregullit, dëshmitarët në çështjet penale kanë të drejtë që të kërkojnë kthimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe pagimin e harxhimeve për ushqim sipas rregullave Shtetërore për kthimin e shpenzimit të udhëtimit / Statens reiseregulativ/. Gjykata do t'Ju lajmërojë se cilat shpenzime keni të drejtë që t'Ju kthehen.

Nëse keni humbur pagesën e punës gjatë kohës së dëshmimit Tuaj, mund të dorëzoni dokumentacionin me shkrim për humbjen, për shembull vërtetimin nga punëdhënësi / bekræftelse fra arbejdsgiver/. Në gjykatë mund të merrni dokumentin për mbulimin e të ardhurave të humbura në punë /Skjema for krav om tapt arbeidsfortjeneste/. Sipas rregullit, në gjykatë nuk jepen shpenzimet për udhëtim dhe pagesa për humbjen e të ardhurave personale, por këto hidhen në llogarinë Tuaj bankare.

Në raste të caktuara, gjykata mund të vendos që shoqëruesit të dëshmitarit /ledsager til et vitne/ t'i paguhen shpenzimet në të njëjtën mënyrë ashtu si dhe dëshmitarit. Kjo mund të ndodhë nëse dëshmitarit i nevojitet shoqërues për shkak të lëvizjes së kufizuar, sëmundjes, moshës, dobësitë e tjera ose për shkaqe të tjera të veçanta.

### **PËR MË TEPËR INFORMATA**

Shihni [www.domstol.no](http://www.domstol.no). Këtu gjithashtu mund të gjeni linkun për sajtin e gjykatës lokale, vendore tek e cila jeni i thirrur. Këtu do të gjeni informata praktike në ndërtesën e gjykatës, daljen para gjykatës, parkimin etj. Gjithashtu shihni [www.politi.no](http://www.politi.no).